



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 713/9 prot.

Tiranë, më 16 . 07.2024

VENDIM

Nr. 11 , datë 16 . 07 .2024

PËR KONTROLLUESIN HOTEL “LUNA MAGICA” LUKOVË

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar (në vijim, “*Ligji*”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*” (në vijim, “*Kodi i Procedurave Administrative*”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit Hotel “*Luna Magica*” Lukovë (në vijim, “*Kontrolluesi*”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 72, datë 26.03.2024 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “*Komisioneri*”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- Verifikimi i ankesës të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga subjekti i të dhënave D. Xh., në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi rezulton i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L14318802A, si person fizik “*Niazi Xhelili*” dhe ushtron aktivitetin në fushën e hoteleri turizmit.

Pranë Zyrës së Komisionerit është paraqitur ankesa e subjektit D. XH, nëpërmjet të cilës pretendon se, Kontrolluesi kryen përpunim jo të ligjshëm të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video-survejjimit CCTV. Konkretisht, ankuesi pretendon se në disa institucione shtetërore qarkullojnë fotografi të ankuesit dhe familjarëve të tij në të cilat është fotografuar jeta private e tyre.

Sipas ankuesit fotografitë janë marrë nga sistemi i video-survejjimit CCTV të Kontrolluesit, pa siguruar paraprakisht pëlqimin për këtë përpunim të dhënash, në shkelje të detyrimeve të Ligjit dhe duke cenuar në mënyrë jo të ligjshme jetën private.

Nga verifikimi në vend gjatë hetimit administrativ, konstatohet se sistemi i video-survejjimit CCTV është teknikisht jashtë funksionit që prej vitit 2019, rrjedhimisht Zyra e Komisionerit vlerëson se, ky fakt nuk përputhet me pretendimet e ankuesit si dhe me provat bashkëlidhur ankesës.

2. Grupi i hetimit administrativ u paraqit në datën 13.06.2024, në ambientet e Kontrolluesit dhe ka bërë me dije Urdhrin e kontrollit. Nga verifikimet e kryera në vend rezulton se, Kontrolluesi në ambientet ku ushtron aktivitetin e tij, ka të instaluar një sistem video-survejjimi CCTV, i përbërë nga 4 kamera të pozicionuara në ambientet e brendshme (hyrja e hotelit, salla e restorantit dhe korridoret).

Konstatohet se, njësia qendrore e sistemit CCTV nuk është funksional dhe kamerat e vëzhgimit nuk janë të lidhura me këtë sistem. Me qëllim verifikimin e pamjeve të sistemit CCTV, grupi i kontrollit i kërkoi Kontrolluesit vendosjen në funksion të këtij sistemi nga ku konstatoi se, data e fundit e regjistrimit i përket vitit 2019.

Megjithatë, pavarësisht faktit se sistemi i video-survejjimit nuk është funksional ai është prezent në ambientet e Kontrolluesit dhe është i dukshëm për klientët dhe vizitorët. Për këtë arsye, Kontrolluesi mbart detyrimin për informimin e klientëve apo vizitorëve, mbi përpunimin e të dhënave të tyre nëpërmjet sistemit të video-survejjimit CCTV, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit *“Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”*, i ndryshuar (në vijim, *“Udhëzimi nr. 3”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe sistemi i video-survejjimit (CCTV). Të dhënat e ruajtura në këto sisteme, si *“imazhe”* apo *“video”* janë të dhëna personale dhe përpunimi i tyre duhet të jetë në përputhje me parashikimet e Ligjit, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesit.

Gjithashtu, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejjimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit. Sipas Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit, subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht

që një sistem video-survejsimi është funksional dhe në veprim, duke vendosur në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese të miratuar nga Komisioneri, për mbikëqyrjen me sistemin e video-survejsimit.

3. Nga verifikimi i kryer në Regjistrin Elektronik të subjekteve kontrolluese dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit rezulton se, Kontrolluesi nuk ka “Njoftuar” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, në kundërshtim me parashikimin e nenit 21 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, detyrimi për “Njoftim” mbi përpunimin e të dhënave personale, sipas parashikimeve të nenit 21 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

4. Rezulton se, Kontrolluesi nuk disponon Rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”.

Në datën 24.06.2024, Kontrolluesi ka dërguar nëpërmjet postës elektronike Rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, e cila nuk përmban elementët formalë për t’u konsideruar një akt i vlefshëm (datë, nënshkrim, vulë, etj.).

Megjithatë, nga shqyrtimi i përmbajtjes së saj konstatohet se, Rregullorja nuk parashikon proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një Rregullore specifike “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektsh), sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, konfidencialitetin, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

5. Kontrolluesi nuk aplikon për punëmarrësit “Deklaratën e Konfidencialitetit”, në përmbushje të detyrimit ligjor që buron nga neni 28 i Ligjit.

Në datën 24.06.2024, Kontrolluesi ka paraqitur në format elektronik një kopje të “Deklaratës së Konfidencialitetit” të plotësuar për punonjësit e tij.

Zyra e Komisionerit vlerëson se qëllimi i nënshkrimit të “*Deklaratës së Konfidencialitetit*” është që, të gjithë punonjësit, të cilët kanë akses në të dhënat personale, të kuptojnë qartë dhe drejtë detyrimet që ata kanë mbi përpunimin e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vënë në dispozicion Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në datë 04.07.2024, deklaroi se do të angazhohet për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara në hetimin administrativ.

Gjithashtu, gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Kontrolluesit dorëzoi edhe Formularin e “*Njoftimit*”.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave “*b*”, “*d*” dhe “*dh*” të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;

d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin që, shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të Kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 18, 21, 27, 28, 29, 30, 39 pika 1, germa “*b*”, “*d*” dhe “*dh*”, si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

- 1- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 40.000 (dyzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit;
 - 2- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenet 27 dhe 28 të Ligjit;
 - 3- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të marrë masa konkrete, për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale;
 - 4- Kontrolluesi në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “Njoftimi” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së përpunimit të të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës;
 - 5- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të përfshijë në Rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, etj.;
 - 6- Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
 - i. vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikën 4 më sipër;
 - ii. brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 3 dhe 5 më sipër;
- Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;
- 7- Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;
 - 8- Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit;
 - 9- Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 16 . 07 .2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi